Më shumë të gjelbërt- mirë për komunat e Bavarisë

Prej plot 40 vitesh,Të Gjelbrit angazhohen kudo në Bavari si politikanë vendor(komunal)kompetent dhe me përvojë-në këshillat bashkiake të qyteteve,komunave,të qarqeve si kryetar bashkishë dhe kryetar qarqesh.Me ,ne Bavaria është në një kurs të mirë dhe të sigurt drejt së ardhmes-me njerëzit dhe për njerëzit.

Thelbësorja që vlen është:Politika jonë e gjelbërt komunale është pranë njerëzve,i merr seriozisht shqetësimet dhe dëshirat (kërkesat) e qytetarëve,ofron zgjidhje dhe kujdeset për një bashkëjetesë të mirë në një mjedis të shëndetshëm.Tani dhe këtu.

Vendbanimi yt bëhet më i mirë me ty.
Për këtë qëndrojmë ne Të Gjelbrit në zgjedhjet komunale 2026 në Bavari.

Shtëpia jonë është vendi ku ne mundemi të skalisim(formësojmë)gjërat ashtu si duhet. Këtë duam ta bëjmë ne Të Gjelbrit-së bashku me ty.Le ta ruajmë atë që duam. Dhe le të ndryshojmë me kujdes atë që nuk funksionon më.Së bashku arrijmë shumë,së bashku e kalojmë më lehtë këtë kohë sfiduese.Këtë e tregojmë ne Të Gjelbrit kudo ku marrim përgjegjësi,qoftë në këshilla,bashki apo në zyrat e qarqeve.

Këtu mbajmë paranë në vend përmes bujqësisë rajonale dhe ndërmarrjeve artizanale dhe përmes prodhimit lokal të energjisë së rinovueshme. Këtu i mbajmë njerëzit bashkë përmes mundësive të barabarta në arsim,hapësira të përballueshme banimi dhe shërbimit (kujdesit)shëndetsor efikas. Këtu krijojmë një jetë të barabartë pëmes një fleksibiliteti dhe mobiliteti miqësor ndaj klimës dhe përmes transparencës dhe mundësive pjesëmarrse në politikën vendore (lokale). Le ti bëjmë së bashku qytetet,komunat dhe fshatrat tona në aspektin social,ekonomik dhe ekologjik vende të forta për një të ardhme të mirë dhe të denjë për të jetuar.

Prioritetet (Thekset,Temat ose Pikat)tona kryesore

Për një bashkëjetesë të fortë

Sheshet e gjallë,të gjelbërta dhe qendrat e fshatrave me cilësi të larta qëndrimi për të gjitha grupmoshat forcojnë bashkëjetesën në komunitet (bashki,vend).Solidariteti rritet aty ku njerzit takohen në mënyrë të barabartë,ku brezat bashkëjetojnë,ku qendrat e banimit-edhe ato pa barriera-janë të përballueshme dhe dyqani i fshatit është i integruar (inkorporuar)në planifikimin banesor.Kudo që një lokal tradicional rrezikohet të mbyllet,në Të Gjelbrit do të angazhohemi për shpëtimin e tij,sepse vendtakime si këto na duhen urgjentisht për të kapërcyer ndarjen (çarjen) në shoqërinë tonë.Ne duam të krijojmë vende dhe lagje për dhe me njerëzit.Vende ku të gjithë mund të jetojnë mire s'bashku.Qendrore për një jetë të mirë për ne paraqet edhe promovimi i artit dhe kulturës.Ato krijojnë identitet,liri kreative dhe ofrojnë mundësi të mëdha zhvillimi.

Ne angazhohemi për forcimin dhe njohjen e vullnetarizmit dhe mbështesim aktivistët Nëpër shoqata.

Njerëzit e përndjekur që janë detyruar të ikin dhe kërkojnë mbrojtje (strehim)tek ne,l pranojmë dhe krijojmë strukturat e nevojshme për këtë.Por politika e mirë e migrimit në nivel lokal kërkon më shumë mbështetje (para)nga shteti (Land)dhe federata (Bund)si edhe struktura administrative efikase mirë të pregaditura.Vetëm në këtë mënyrë integrimi mund të ketë sukses qoftë në lokalitet,në kopsht,shkollë apo në jetën profesionale.

Ne angazhohemi për një shoqëri ku diversiteti zë një vend qendror dhe ku secili kontribuon në formësimin e shoqërisë (vendit),pavarsisht asaj është 16 vjeçar apo 76 vjeç, pavarsisht nëse është bavarez autokton apo i sapo ardhur kohët e fundit këtu.

Për më shumë gra në vendimmarrje

Me 8 mars 2026 mbahen zgjedhjet lokale por gjithashtu është edhe Dita Ndërkombëtare e Gruas.Të shfrytëzojmë këtë rast dhe këtë ditë për të përçuar një sinjal të qartë për më shumë gra dhe diversitet në politikën komunale.

Një politikës e mirë komunale ka nevojë për më shumë gra në vende përgjegjëse.Sepse gratë kanë një këndvështrim tjetër sa i përket udhëtimit për n'punë,kujdesin,kujdesin ndaj fëmijëve,arkitekturën,transportin publik,qendrat e kohës së lirë,jetën e shoqatave,vullnetarizmin…Më shumë gra në vendimmarrje janë një fitim për çdo vend. Ne të Gjelbrit nuk kërkojmë vetëm gjysmën e pushtetit për gratë por atë e zbatojmë në praktikë.Tashmë gratë kanë 50 % të mandateve të gjelbra në këshillat komunale të Bavarisë.Ndërsa në të gjithë Bavarinë,pjesmarrja e grave në këshillat komunale është vetëm 22% kurse tek CSU është edhe më pak,vetëm 20 % gjë që është e turpshme.Ne të Gjelbrit për një bashkëjetesë të barabartë,që përfshinë prespektiva të ndryshme jetese në të gjithë diversitetin e tyre dhe që u mundëson grave të marrin pjesë aktive në vendimmarrje.

Për diversitet në banim

Ne të Gjelbrit luftojmë për më shumë hapësira banimi me kosto të përballueshme,sepse ato mungojnë gjithnjë e më shumë në shumë lokalitete të Bavarisë.Ne të Gjelbrit e marrin seriozisht rolin qendror të komunave dhe angazhohemi për krijimin e konturave të mirëfillta politike duke mundësuar drejta të reja ndërtimi ,përdorimin social të tokës,krijojmë banesa sociale dhe të drejta përdorimi ose mbështetemi në tendera konceptual vendor ose modele kooperuese banimi.Kështu të rinjët dhe të moshuarit mund të qëndrojnë në vend edhe në regjionet me rritje të dendësisë se banimit.Kështu lind hapësira banuese e larëmishme sa njerëzit të mund të jetojnë në të.

Ne e mbështesim fillimisht zhvillimit mbrenda qendrave të fshatrave,duke shfrytëzuar

tokat e papërdorura dhe duke rigjallëruar hapësirat boshe.Kjo i bënë lokalitetet tona më tërheqëse dhe redukton shfrytëzimin e sipërfaqes.Në këtë mënyrë lokalitetet ruajnë origjinalitetin e vet dhe njerëzit kanë një copë atëdhe.Dendësimi i matur në qendrat urbane kursen gjithashtu sipërfaqe dhe ruan gjelbërimin freskues.

Ideja jonë për banim bashkon qëndrueshmërinë ekologjike dhe sociale.Si ndërtojmë dhe si rinovojmë është një pyetje kyçe në rrugën drejt një shoqërie klimatikisht të qëndrueshme,ku të gjithë mund të jetojnë mirë.Ne mbështesim forma banimi dhe punë me kosto të ulët,të qëndrueshme,gjithëpërfshirëse ose eksperimentale si në qytete ashtu edhe në qendrat e vjetra të fshatrave apo në shtëpitë e vjetra tradicionale në vendet rurale. Na nevojitet më tepër hapësirë banimi fleksibil që i përshtatet nevojave të ndryshme të jetës sonë-familjet e reja kanë nevoja tjera nga të moshuarit.Shumë njerëz janë krijues,të orientuar drejt së mirës së përbashkët dhe duan të marrin pjesë aktive në formësimin e mjedisit të tyre të jetesës dhe banimit.Ne të Gjelbrit krijojmë mundësinë për këtë,duke lejuar modele banimi ose duke vënë në dispozicion parcela të përshtatshme.

Për arsim efikas dhe harmoni familjare

Çdo fëmijë meriton mundësi të barabarta arsimimi,pavarsisht nga të ardhurat e prindërve dhe pavarsisht në cilin vend (komunë)banon dhe gjendja buxhetore e saj.Ne I japim fund gjendjes së shkollave të rrënuara (marode),infrastrukturës së vjetëruar apo mungesave të shpeshta të kujdesit.Komunat kanë nevojë për më tepër mbështetje financiare ,për të përmbushur nevojat e tyre që vijnë duke u rritur si dhe investimet e nevojshme në ndërtesat shkollore dhe kopshtet.Atyre u duhet mbështetje edhe për më tepër personel të kualifikuar për të menaxhuar entet shkollore e edukative. Sepse që çdo fëmijë të ketë mundësitë e barabarta në jetë ,nevojitet një kujdes I vazhdueshëm dhe efikas në lokalitet dhe shkolla moderne dhe të pajisura mirë.Këtu bënë pjesë edhe ngritja e përhershme e kujdesit social nëpër shkolla.Për prindërit,dhe veçanarisht për nënat,një kujdes cilësor dhe efikas (i besueshëm)gjithëditor për fëmijët,lehtëson mundësitë dhe shanset e barabarta në tregun e punës.Kështu bëhet e mundur që familja dhe angazhimi profesional (puna)të pajtohen pa stres dhe ndjenjë faji.

Për një ekonomi me prespektivë (që ka ardhmëri)

Ne të Gjelbrit jemi forca lëvizëse për sigurimin e ardhëmërisë së ekonomisë sonë lokale. Ne krijojmë një mjedis miqësor për inovacionin:me pak burokraci,të qëndrueshëm.Ne forcojmë vlerat e krijuara rajonale dhe bashkëpunimin ndërkomunal.Ne i bëjmë qytetet dhe komunat tona tërheqëse për ardhjen e fuqisë së kualifikuar punëtore:përmes banimit të përballueshëm (kosto të lirë),hapjes ndaj botës dhe një kujdes të shtuar (të mirë)familjar (për fëmijët).Ne shtyjmë përpara zgjerimin e infrastrukturës digjitale dhe mbështesim transformimin drejt teknologjive neutral klimatike kudo që mundemi-për ndërmarrjet tona,për bizneset (artizanatet)dhe për njerëzit që punojnë në to dhe jetojnë këtu.

Ne krijojmë kushte të mira dhe efikase për ofertat e reja dhe të qëndrueshme nga ndërmarrjet. Masa të provuara janë kadastrat diellore,planifikimi i ngrohjes,promovimi

iFairtrade, menaxhimi ndërkomunal i sipërfaqeve,mobiliteti i përbashkët ose bilancimi i CO2 për ndërmarrjet vendore.
Ne mbështesim ndërmarrjet që të sjellin në treg produkte dhe shërbime të reja mbrojtëse dhe klimaneutrale.Krahas strukturave lokale të tregtimit,produktet rajonale duhet të jenë gjithnjë e më shumë të disponueshëm edhe online.Shërbimet tona të shpërndarjes do të forcojnë në të ardhmen tregtinë vendore me produktet e veta rajonale.Kështu krijojmë burime të reja t'ardhurash,vende të reja pune dhe njëkohësisht sigurojmë furnizimin e afërt për njerëzit në vend (funizimin e afërt lokal).

Për energjinë lokale (vendore)

Ne të Gjelbrit sigurojmë që ndërmarrjet vendore asht si edhe qytetarët të furnizohen në mënyrë të besueshme,të pavarur dhe të sigurt me energji të lirë nga era dhe dielli. Kështu mbrojmë ekonominë dhe klimën tonë.Ne krijojmë në vend kornizën që energjia jonë të prodhohet sa më efikas dhe në mënyrë sa më të decentralizuar.Sepse një sistem me shumë impiante të vogla është më rrezistent ndaj krizave sesa sistemii vjetër energjetik me centralet e mëdha,të vjetra dhe të shtrejtë.

Me impiante të decentralizuara fitimet (paraja)e realizuara mbeten te ne (në lokalitet).Nga panelet diellore private në ballkon deri te impiantet agri-fotovoltaike,që u mundësojnë fermerëve të ardhura shtesë. Nga gjeotermia deri tek energjia diellore ose e erës me pjesmarrjen e kooperativave energjetike qytetare:në tranzicionin energjetik në vend mund të marrin pjesë të gjithë dhe të gjithë përfitojnë.Ne duam që të gjithë qytetarët të bëhen fitues të energjisë-qoftë përmes një çmimi të reduktuar të energjisë elektrike,vetfurnizimit ose si aksionarë në impiantin e erës pranë fshatit.Edhe komunat vetë duhet të përfitojnë nga prodhimi i energjive të rinovueshme përmes turbinave të erës, fotovoltaikëve etj.,përtej tatimit mbi fitimin,përmes një bonusi "bonusi fitues energjie ".Atëherë turbinat e erës në vend financojnë indirekt një pjesë të pishinës publike.

Nevoja jonë për ngrohje përbën më shumë se gjysmën e konsumit total të energjisë .Ne të Gjelbrit i ndihmojmë qytetarët që të pavarsohen nga energjia e shtrejtë nga burimet fosile.Për këtë ne shtyjmë përpara planifikimin komunal të ngrohjes.Ai jep orientimin e nevojshëm për vendimet e investimeve,indentifikon mënyrën më ekonomike të furnizimit me ngrohje dhe kështu krijon siguri planifikimi.Ku është e mundur,krijojmë rrjete furnizimi me ngrohje lokale.Ne angazhohemi për një këshillim fillestar falas për çështjet e energjisë dhe mundësitë e subvencioneve,për të mbështetur të gjithë qytetarët në zëvenfëdimin klimë-miqësor dhe ekonomik të sistemeve të ngrohjes.

Për mobilitetin e së ardhmës (të nesërmës):i besueshëm,i përshtatshëm,i lirë (ekonomik).

Mobiliteti është cilësi jete.Ne të Gjelbrit e formësojmë atë të besueshëm (efikas,transparent),të përshtatshëm (komfor)dhe të përballueshëm financiarisht dhe me synimin klimaneutral.Rruga:Koncepte mobiliteti,që në fshat dhe në qytet janë të ndryshme,por që funksionojnë për të gjithë-për të rinjtë dhe të moshuarit,për të

punësuarit,familjet dhe vizitorët,si dhe për njerëzit me dhe pa aftësi të kufizuara.Për këtë krijojmë më shumë rrugë të sigurta dhe tërheqëse për këmbësorët në jetën e përditshme,më shumë rrugë për biçikleta dhe një infrastrukturë të qëndrueshme për karikim elektrik,më tepër sharing oferta dhe stacione mobiliteti.Pikërisht edhe në fshat angazhohemi për zgjerimin e transportit publik pa barriera,krijojmë lidhje me autobusë ndërurban ndërmjet qendrave të lokaliteteve dhe mbështesim ofertat sipas kërkesave.Sepse në fokus qëndron një infrastrukturë mobiliteti që orientohet sipas nevojave të ndryshme të njerzëve,që mundëson pavarsinë mobile me ose pa patentë shoferi ose me apo pa automobil.Ne i çlirojmë njerëzit nga varësia e automobilit.Në të jejtën kohë automobili në zonat rurale do të mbetet mjeti i vetëm dhe i nevojshëm mobiliteti (bartjes,transportit)-por në të ardhmen një mjet transporti elektrik.Ne të Gjelbrit angazhohemi për "Vizionin Zero ",pra për synimin që të mos kemi viktima trafiku në lokaliteten tona,në asnjë familje.Ne e formësojmë shumëllojshmërinë e mobilitetit ashtu që të garantohet siguria e të gjithë pjesëmarrësve në trafik .Këmbësorët dhe çiklistët i marrim parasysh në çdo planifikim rrugësh.Kështu krijojmë një vlerë më tepër për të gjithë.Në fshat,në qytet dhe kudo në mesin tonë.

Për një vizion në kohën e krizës klimatike

E ndjejmë.Kriza klimatike është e pranishme.Ditët e nxehta po shtohen,ashtu edhe ngjarjet ekstreme të motit me breshër,stuhi dhe reshje të dendura.Nxehtësia ekstreme është veçanarisht një rrezik për shëndetin e më të vegjëlve dhe të moshuarve në mesin tonë.

Ne kërkojmë një menaxhim të ngrohjes klimatike (vapës së madhe)dhe shirave në lokalitetet tona. Duhet ti ristrukturojmë qytetet dhe vendbanimet tona,t'i çbetonizojmë sipërfaqet e mbuluara në mënyrë që të thithin dhe ruajnë ujin e akumluar.Kështu e mbrojmë pasurinë tonë në kohët e krizës klimatike nga përmbytjet.

Na duhen urgjentisht më shumë pemë hijëdhënëse dhe rezistente ndaj nxehtësisë,hapësira të gjelbra të ndërlidhura dhe korridore ajri të freskët,sipërfaqe ujore të hapura,gjelbërim fasadash dhe çatishë ,por edhe çezma publike dhe ulëse (banka) në hije në sheshe publike.Kështu krijojmë gjithashtu edhe vende të bukura,që ftojnë për të qëndruar dhe për t'u takuar-për një bashkëjetesë të gjallë.

Për tokën që krijon jetë

Peisazhet e larmishme dhe tokat e gjalla (të punuara)janë bazë e jetës sonë.Këtu kultivojnë fermerët tanë ushqimet tona.Këtu shiu depërton dhe lind uji ynë i pastër i pijshëm,këtu moçalet akumulojnë CO_2 .Pylli freskon dhe pastron ajrin tonë,peisazhet e lumenjëve na mbrojnë nga përmbytjet.Këtu jeton shumica e kafshëve dhe bimëve,nga bleta e egër deri te zambaku i malit.

Ne të Gjelbrit sillemi me përgjegjësi me livadhet dhe arat tona,sepse ato janë shumë të

vlefshme për ti mbuluar me lehtësi me beton dhe asfalt.Në Bavari humbin çdo ditë përmes ndërtimit 10 hektar tokë e vlefshme.Këtij shfrytëzimim të pakontrolluar të tokës ne i kundërvihemi.Ai shkatërron mjedisin,biodiversitetin tonë,ia merr bujqësisë bazën e ekzistencës dhe ka pasoja masive për mjedisin tonë.Në mbarë Bavarinë ne kërkojmë kufizimin e shfrytëzimit (konsumimit)të tokës në maksimum 5 hektar në ditë.Në vend (lokalitet)i shqyrtojmë të gjitha planet e ndërtimit për potencialin e ndërtimit,kursimit të sipërfaqes ndërtuese dhe mundësitë e çbetonizimit.

Për shëndet më të mirë dhe kujdes pranë vendbanimit

Shëndeti është gjëja më e rëndësishme që të mund të shijojmë jetën tonë .Ne të Gjelbrit mbështetemi te mjekët e përgjithshëm dhe specialistët në vendbanim dhe një kujdes shëndetësor brenda mundësive.Ne duam ti mbajmë mjekët e përgjithshëm,pediatrët dhe specialistët në vend dhe gjithashtu të fitojmë të rinj.Për këtë krijojmë më shumë hapësira për ordinanca mjekësore të përbashkëta dhe qendra mjekësore të drejtuara nga mjekët.Ne përmirësojmë kujdesin ambulator dhe zgjerojmë qendrat e kujdesit. Edhe mamitë duhet të jenë në gjendje të arrijnë shpejt në fshat dhe në qytet.Spitalet i pajisim me mjete të mjaftueshme financiare (para)dhe u mundësojmë specializime për cilësi më të mirë.Kështu garantojmë konkretisht sigurinë e kujdesit mjekësor në fshat dhe në zonat urbane.

Për një politikës që të dëgjon

Këshilltarët tanë vullnetar janë aktiv në terren për të dëgjuar ty.Ne përfshijmë të gjithë qytetarët e interesuar në punën tonë këshillimore.Ne jemi jemi të pranishëm në tryeza të rregullta diskutimi dhe orë dëgjimi për të dhënë përgjigje.Në komunën tonë ftojmë të rinjtë dhe i udhëheqim në të.Të gjithë të rinjtë në çdo komunë meritojnë një forum rinor ose parlament rinor-kjo për ne është një gjë e vetkuptueshme.Ne i marrim të rinjtë seriozisht dhe i mbështetim ata dhe idetë,projektet e tyre me mjete financiare.Ne duam në komunën tonë sa më shumë qytetarë pjesëmarrës.Tubimet e qytetarëve duhet të marrin parasyshë idetë e qytetarëve.Ne mbështesim forumet e qytetarëve (këshillat) siq janë këshillat për personat me aftësi të kufizuara apo këshillat qytetare për të moshuarit.Për ne është e vetëkuptueshme qasja transparente në procesverbalet dhe vendimet e këshillave. Ne qëndrojmë për një kulturë debati të bashkëpunimi dhe i kundërvihemi përjashtimit nga debati dhe armiqësive.Synimi ynë është ti bëjmë njerëzit krijues aktiv në vendbanimet e tyre,pavarsisht preardhjes së tyre sociale moshës,gjinisë,arsimit,të kaluarës së tyre migrative apo aftësive trupore.Sepse çdo këndvështrim është i rëndësishëm dhe ka nevojë për hapësirë.Vetëm kështu demokracia e jonë mbetet e forte dhe e gjallë.